



**AUTO CLUB  
ALBANIA**

Automobile Club Albania

Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania

T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,

E: [info@aca.al](mailto:info@aca.al) / E: [www.aca.al](http://www.aca.al)



FEDERATA SHQIPTARE E SPORTEVE TE AUTOMOBILIZMIT

Rruga "Ismail Qemali" Nr 32/1 Tirane, 1001.

Tel. +355 42 257828

info@aca.al

*Be at the heart of motorsport...*



*...be a marshall!*

MEMBER OF





# Manual për Marshallët

## Përmbajtja

- Pajisjet personale
- Përgatitja
- Spektatorët
- Radiot
- Fikja e zjarrit
- Marshalli i garës
- Flamujt
- Ndihma e shpejtë
- Hill Climb
- Kartingu

### - Pajisjet personale

Është e rëndësishme për marshallët të veshin pajisjet e duhura. Në shumë evente nuk do ju duhen asnjë nga pajisjet speciale, por në disa të tjera me veshjet e gabuara, egziston rreziku i hipotermisë në dimër dhe djegieve nga dielli ose goditjeve nga nxehtësia në verë.

Përgatitu për më të keqen dhe mos harro që mund të heqësh një shtesë veshjesh nëse është shumë vapë, dhe konsideroni veshje ekstra për ditë të ftohta.

Marshallët nuk duhet ti afrohen shumë zjarrit dhe për këtë kanë fikëse zjarri. Por, sidoqoftë për kujdes vishuni me veshje me fibra natyrale (pambuk, lesh) sidomos ato veshje në kontakt me lëkurën, sepse fibrat e prodhuara mund të shkrijnë edhe nën kominoshet mbrojtëse dhe shkaktajnë djegie. Gjithmonë mbuloni krahët dhe këmbët edhe kur është nxehtë.

Kapelet janë gjithmonë të rëndësishme sepse humbasim një masë të madhe të nxehtësisë së trupit nga koka në kohë të ftohtë ndërkohë që ju mbron nga dielli në kushte nxehtësie.

Kambale me përforcim janë të rekomanduara. Mos vishni atlete, nuk ju mbrojnë dhe nuk japin suportin e duhur për kyçet e këmbës dhe rrallëherë janë kundra ujit.

Në evente të tjera kominoshet mbrojnë rrobat tuaja dhe japin më shumë mbrojtje kundra zjarrit nëse janë të trajtuara me material antizjarr. Gjithmonë merrni me vete veshje kundra shiut dhe shmangni najlonin e hollë. Zgjidhni ngjyra që mos ngatërrohen me flamujtë, portokallia është idealja.

Ju duhen doreza për të mbajtur duar ngrohtë në disa evente. Vishini të trasha që të jenë pak të lirshme dhe kini parasysh të mbani një palë rezervë ose kundra ujit. Sidoqoftë, edhe duke përdorur dorezat është më kollaj dhe më e shpejtë të shkelmosh mbeturinat jashtë ruge sesa ti ngresh ato me dorë.



Tapa veshësh ose kufje janë esenciale nëse do qëndroni afër zhurmave të përqenduara. Syzet mbrojtëse nuk janë detyrim, por janë të këshillueshme nëse do qëndroni afër vendeve ku ka zhavor.

Mbani krem kundra diellit sepse është shumë kollaj të digjeni nga dielli duke qëndruar gjithë ditën në diell.

Gërshërët janë praktike, lloji që pret gjithçka që nga rripat e sigurimit deri te tubat e frenave, po ashtu edhe kaçavidë me dy anë pllakë dhe kryq dhe në disa evente një çekiç për të ngulur tabela ose kunjja.

Gjithmonë merrni mjaftueshëm ushqim dhe pije, por jo alkol. Bëni një listë për t'u kujtuar për gjërat e nevojshme.

## - Përgatitja

Çfarëdo eventit qoftë, (hill climb, rally ose tjetër), disa elemente vlejné për të gjitha llojet e garave.

Kontakto në kohë me drejtorin e marshallëve, kontrolluesin ose organizatorin e eventit.

Qartësohu ku do pozicionohesh dhe në çfarë ore duhet të jesh atje.

Qartësohu se cila do jetë detyra jote dhe a i ke të gjitha pajisjet e nevojshme për ta bërë atë.

Prezantohu me marshallët e tjerë dhe njihi me atë që është kryetar grupi.

Sigurohu që kupton sistemin e komunikimit që do të përdoret. Komunikim i qartë dhe pa gabime midis marshallëve është jetësor për të shmangur konfuzionin.

## - Spektatorët

Motorsporti i mirëpret spektatorët, por ka përgjegjësi kundrejt tyre dhe këtu marshallët luajnë një rol kyç.

Mos harroni që disa spektatorë mund të jenë të rinj në këtë sport dhe duhen edukuar për rreziqet. Mënyra më e mirë është që të jenë shembull për spektatorët. Marshallët nuk duhet të parkojnë keq për shkak të mundësisë që kanë. Nëse marshallët qëndrojnë duke bërë muhabet apo më keq akoma duke pirë duhan apo duke mbajtur një aparat fotografik ose një qen, në këtë mënyrë nuk mund të kërkojnë respekt nga spektatorët apo të kenë bashkëpunim.

Shumica e nerëzve reagojnë pozitivisht nëse informohen me edukatë për atë që po ndodh. Është sjellja arrogante e marshallit që sjell reagime të këqija dhe provokon përgjigje armiqësore. Mesazhi duhet të jetë "nëse do shkosh aty, kujdes sepse... ose nëse do shkosh aty, kalo nga kjo anë sepse është më e sigurtë. Një marshall duhet të tregojë që e kupton pse një spektator ka nevojë të shkojë diku.

## - Radiot

Nëse jeni duke përdorur radio komunikimi, sigurohuni që radio të jetë e ndezur dhe në kanalën e duhur. Përdorni frekuencën e përshtatshme për eventin.

Pasi të keni raportuar, mbajeni radion gjithmonë afër.

Radiot konsumojnë bateri prandaj nëse je në makinë, ndiz motorin rregullisht për ta karikuar.



**AUTO CLUB  
ALBANIA**

Automobile Club Albania

Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania

T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,

E: [info@aca.al](mailto:info@aca.al) / E: [www.aca.al](http://www.aca.al)



FEDERATA SHQIPTARE E SPORTEVE TË AUTOMOBILIZMIT

Rruga "Ismail Qemali" Nr 32/1 Tirane, 1001.

Tel. +355 42 257828

[info@aca.al](mailto:info@aca.al)

Dëgjo përpara se të flasësh. Të tjerët mund të kenë nevojë për linjë të lirë. Jepni mesazhe të shkurttra dhe flit vetëm kur e ke të nevojshme ose kur të kërkohet.

Puno si pjesë e skuadrës, operatorët e radiove do të jenë goja dhe veshët e skuadrës, por mos harroni që lajmërimet e urgjencave kanë prioritet, kështu që nëse dikush po lajmëron për doktor, nuk është koha për të pyetur si janë rezultatet e skuadrës në linjën e marshallëve.

Menduhu çfarë do të thuash përpara se të shtypësh butonin për të folur dhe pastaj flit duke e mbajtur pak në distancë mikrofonin e radios në mënyrë që të shmangësh zhurmën e frymëmarjes tënde në transmetim.

Ji i qartë në cilën gjuhë duhet folur dhe më e rëndësishmja lësho butonin kur ke mbaruar së foluri!

Liro linjën sa më shpejt të jetë e mundur. Nëse nuk e di përgjigjen e pyetjes thuaj jo ose thuaj prit pak, derisa ta gësh. Nëse ke mesazh të gjatë sidomos kur ke një listë me informacion që ka nevojë të shënohet, thuaj pause, kështu që të gruposh mendimet dhe ata në anën tjetër të mbajnë shënimet.

Në rast urgjence, gjyko situatën që të mos mbivlerësosh urgjencën e mesazhit tënd. Për të marrë prioritet ndaj folësve të tjerë thuaj një nga fjalët si vijojnë:

Prioritet - prioritet maksimal. Dëmtim i konfirmuar që kërkon shërbimin mjekësor ose zjarrfikës.

Urgjent - kërkon veprim të menjëhershëm. Makinë në vështirësi ose dyshohet për dëmtim.

Siguri - prioriteti më i ulët. Mesazhe që i përkasin sigurisë së pistës që një vonesë në veprim mund të tolerohet.

Dhe në rastet kur përdor radion, mos harro që me shumë gjasa është një spektator që po ju dëgjon.

## - Fikja e zjarrit

Zjarret janë të rralla në motorsport, por kur ndodhin, vendosmëria është thelbësore. Dhe në këto raste, rekomandohet trajnimi. Prioriteti është të shpëtosh jetë, pastaj të mbrosh pronën. Rreziku më i qartë për një pilot është djëgia, por zjarri djeg oksigjenin dhe mungesa e tij rezulton në dëmtime të trurit ose edhe vdekje përpara se viktima të digjet.

Qëllimi është të arrish te një mjet që po digjet dhe të vesh zjarrin nën kontroll dhe mundësisht ta fikësh brenda 30 sekondash. Shkëput elektricitetin në mënyrë që karburanti të mos vazhdojë të pompohet në një motor të nxehtë.

Për të fikur zjarrin njihi me llojin e fikëses në përdorim dhe si funksionon ajo.

Vepru si skuadër. Afrohu në krahun e njëjtë me erën që të mos të fryjë tymin ose pluhurin në fytyrë.

Ndalu 3-4 metra larg nga flakët. Mos u afro shumë sepse fuqia e fikëses mund të shpërndajë karburantin që digjet.

Nëse shoferi ka ngecur brenda, kabina ka prioritet. Nëse piloti është jashtë, por ka marrë flakë, shtrije përtokë dhe fike zjarrin me goditje të lehta ose me fikëse. Nëse shoferi është jashtë dhe i sigurtë, atëherë përqëndrohu në vatrën e zjarrit.

Sulmo flakët në vatër me zjarrfikëse me pluhur, spruco shkumë mbi zonën e zjarrit për ta ftohur dhe izoluar atë.

Mos mbulo kolegët me flakë, pluhur apo shkumë. Mos vrapo përmes zjarrit, por fik flakët në tokë duke u afruar. Kujdes për flakët që rikthehen, poshtë makinës, në zonën e motorit, etj.

MEMBER OF





Kur flakët të jenë shuar, lage mjetin dhe vazhdo shiko, fikëset janë domosdoshmëri kur pastron një makinë që është djegur.

Pjesë plastike ose gome që janë djegur mund të prodhojnë acide të fuqishme që shkaktojnë dëmtime të rënda nëse bien në kontakt me lëkurën tënde. Nëse ke ndjesinë e djegies shko në një qendër shëndetësorë ose spital dhe informoi që ke qenë në kontakt me acide që vijnë nga goms e djegur.

Raporto numrin dhe llojin e fikëseve të zjarrit që ke përdorur që të zëvendësohen. Zëvendëso edhe ato që janë përdorur pjesërisht.

Në rast të zjarreve ose aksidenteve madhore, mund të kontaktohesh nga gazetarë ose spektatorë për komente. Duhet ti referoni gjithmonë drejt zyrtarëve të garës ose eventit.

## - Marshalli i garës

Cilado qoftë puna juaj njëherë që je në pozicion njihuri me marrshallët e tjerë dhe qartësohuni kush do bëjë çfarë. Zakonisht në vëndin e marrshallëve do gjeni një shef marrshallësh, një marrshall flamujsh, një lider skuadre dhe skuadrën e incidenteve.

Mos harro që siguria juaj është e rëndësishme që të jeni në gjëndje të ndihmoni dikë tjetër. Nuk është ide e keqe që kur të arrini në vendndodhjen e marrshallëve të kontrolloni për rrugët e daljes- edhe sikur të kalosh një gardhtë hidhesh nga një lartësi apo të fshihesh mbas ndonjë barrierre të fortë nëse një makinë vjen drejt teje. Gjithmonë mundohu të mbash një sy te trafiku që vjen i garës. Kurdo që të jetë e mundur shmangu kthimin e shpinës nga gara.

Nëse ndodh një incident prit të pastrohet pluhuri. Makina mund të niset.

Qëndro në bankinë deri në momentin e fundit të mundshëm- nëse kë një lider skuadre prit për sinjalin e tij dhe pastaj përdor rrugën më të sigurtë për tu afruar mjetit.

Gjithmonë merr një fikës zjarri, por mos merr një nga posti yt nëse do kalosh një tjetër rrugës. Puno si skuadër. Vendos strategjinë pastaj vepra dhe përdor makinën e përfshirë në aksident si mbrojtje duke e mbajtur midis teje dhe trafikut në ardhje. Shiko dhe dëgjo për rrezik dhe nëse dëgjon një fishkëllimë, shiko dhe merr masat e duhura. Nëse janë më shumë se një makinë atëherë nda resurset.

Kontrollo trafikun midis sesioneve, trajto ndonjë derdhje vaji, mblidh ndonjë pisllik, fshij dhe apo zhavorr nga rruga dhe raporto ndonjë dëmtim të rrugës te shefi i postit.

Në garë komunikimi i qartë është i rëndësishëm midis marrshallëve dhe vlen të dish shenjat bazike me duar.

Nëse një shofer ka ngecur ose ka nevojë për asistencë mjekësore dhe nuk keni një doctor, infermier ose ambulancë thërrit skuadrën e shpëtimitsepsë në të duhet të jetë një mjek.

Marshalli kryen disa sinjalizime me duar, të cilat janë të pasqyruara si më poshtë:



**AUTO CLUB  
ALBANIA**

Automobile Club Albania

Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania

T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,

E: [info@aca.al](mailto:info@aca.al) / E: [www.aca.al](http://www.aca.al)



FEDERATA SHQIPTARE E SPORTEVE TE AUTOMOBILIZMIT

Rruga "Ismail Qemali" Nr 32/1 Tirane, 1001.

Tel. +355 42 257828

info@aca.al



Duart e kryqëzuara  
Kërkohe ndihmë mjekësore



Duart në formë F  
Kërkohe ndihmë ndaj  
zjarrit



Duart në formë Ë  
Kërkohe pajisje shpëtimi



Prekja e kokës  
Nevojitet asistencë



Duart në formë T  
Nevojitet tërheqje për  
makinën



Duart në formë T të  
ngritura.  
Përveç tërheqjes, nevojitet  
edhe ndërhyrje vinçi.



Lëvizja e harkuar e dorës  
Substanca të lëngshme në  
pistë.



Pozicioni OK  
Situata është në rregull.



A është e sigurtë të kalohet  
në pistë?  
Dora e ngritur – nuk është e  
sigurtë.  
Dora e ulur – lejohet kalimi

MEMBER OF





**AUTO CLUB  
ALBANIA**

Automobile Club Albania

Rr. "I. Qemali" Nr. 9, H. 2, Nj. A. 5, 1019 Tirana, Albania

T: +355 4 2387011 F: +355 4 2387018,

E: [info@aca.al](mailto:info@aca.al) / E: [www.aca.al](http://www.aca.al)



FEDERATA SHQIPTARE E SPORTEVE TE AUTOMOBILIZMIT

Rruga "Ismail Qemali" Nr 32/1 Tirane, 1001.

Tel. +355 42 257828

info@aca.al

## - Flamujt



Flamuri jeshil – Fillimi i garës



Flamuri i kuq – Ndalim i menjëhershëm



Flamur i verdhë – Paralajmëron rrezik në pistë



Flamur i verdhë me vija vertikale të kuqe – Pista e rrëshqitshme



Flamur me katrorë të bardhë dhe të zinj – Fundi i garës

## - Ndhimja e shpejtë

Motorsporti vërtet nuk është një ndër sportet më të rrezikshme, por pavarësisht masave mbrojtëse, mund të ndodhin përplasje me shpejtësi të lartë, makinat marrin flakë dhe njerëzit të dëmtohen, prandaj veprimi që marshallët bëjnë në minutat e para mund të ketë një impakt shumë të madh.

***Pavarësisht të gjithave, mos harroni se siguria juaj është thelbësore. Ju nuk mund të ndihmoni askënd nëse jeni i dëmtuar.***

Mbajeni makinën e përplasur midis jush dhe trafikut që vjen. Gjithashtu, mendohuni përpara se të veproni.

Sigurohuni që nuk ka njerëz që po pinë duhan pranë një makine të përplasur.

Fillimisht, fikni zjarrin dhe më pas mundohuni që të izoloni pjesët elektrike.

Nëse është e mundur, gjithmonë afrohuni tek një pilot i përplasur nga një drejtim i cili të jetë brenda fushëpamjes së tij – reagimi i tyre, ose mungesa e këtij reagimi, do të jetë një tregues kyç nëse ka nevojë për ndërhyrje të mëtejshme.

Ndalo një çast për te vlerësuar situatën, përpara se të kërkosht ndihmë.

## - Hill Climb

Të njëjtat parime aplikohen edhe tek marshallët e garave të shpejtësisë (Hill Climb dhe sprinte) si ato që aplikohen te garat e pistave. Garat e shpejtësisë kanë bokse, Drejtor Gare, Gjyqtarë, ekipet e shpëtimit dhe tërheqjes, kontrollin teknik që ka të njëjtin funksion si kontrolli i garës në pista dhe postet e marshallëve ku ndodhen vëzhguesit.

Garat e shpejtësisë kanë një procedurë nisjeje më komplekse sesa garat e tjera. Gara ndalohet në momentin që ka një aksident.

MEMBER OF





## Marshallët në vendet e garave Hill Climb

Pozicionet e marshallëve në Hill Climb kanë 4 detyra kryesore:

- Vëzhgimi
- Komunikimi
- Flamujt
- Menaxhimi incidenteve

Zakonisht, marshallët mund të kryejnë disa nga këto detyra dhe jo vetëm njërën.

## Marshallët-vëzhgues në Hill Climb

Detyra e vëzhguesit është e përafërt me atë të vëzhguesit në pista. Vëzhguesi duhet:

1. Kontrollon në qoftë se pajisjet funksionojnë.
2. Të komunikojë me ekipin e marshallëve që të gjithë të dinë se çfarë pritet nga ata.
3. Të vendosë një marshall që të merret me komunikimin me Drejtuesit e Garës si dhe një marshall për flamujt. Këto detyra mund të ndërrohen midis sesioneve.
4. Të kontrollojë gjatë të gjithë kohës rrugën për vaj ose mbetje të rrezikshme.
5. Të njoftojë për ndalimin e sesionit në mënyrë që të pastrohen mbetjet e rrezikshme.
6. Të bëjë raportime dhe skica siç kërkohet nga organizatorët.
  - a. Të kontrollojë se çfarë raportesh kërkohen. Në disa raste këto kërkohen vetëm në raste dëmtimesh dhe në raste kur thyhet rregullorja dhe një pilot mund të penalizohet me kohë.

## Komunikimi

Marshalli që merret me komunikimin kontakton Drejtuesit e Garës dhe dërgon mesazhe sipas urdhrave të Vëzhguesit si dhe funksionon si një sy i dytë për Vëzhguesin.

## Flamujt

Marshalli me Flamurin e Kuq duhet ta përdorë atë në rastet:

1. Kur e shfaq marshalli në pozicionin pas teje
  - Kjo është një kërkesë në të gjitha garat Hill Climb dhe Sprintet. Llogaria që duhet të kryesh është që mbetjet në rrugë të mund të pastrohen deri në kohën që vjen garuesi i radhës.
  - Kontrolloni gjithmonë pikën e flamurit tjetër përpara se piloti i radhës të futet në sektorin tënd dhe të sigurohesh që asnjë flamur nuk është i ngritur.
2. Kur në rrugë është e pranishme një makinë pa numër garimi. (Nuk lejohet prania e makinave private në rrugë në momentin që zhvillohet gara, përveç rasteve kur është e autorizuar dhe shoqëruar nga makina e sigurisë).
3. Nëse ka spektatorë ose kafshë në rrugë.





- Garat Hill Climb bëhen në zona rurale ku mund të ketë edhe qarkullim të bagëtive.
- 4. Nëse marshallët po punojnë në rrugë.
- 5. Kur ka një incident në sektorin tënd, në mënyrë që të bëhet e mundur që piloti i radhës të ndalojë, të ngadalësojë apo të ndërrojë rrugë.
  - Një flamur i kuq nuk është i nevojshëm në rast se makina rrëshqet dhe për sa kohë që nuk mund të kapet nga piloti radhës.
  - Një flamur i kuq duhet të shfaqet nëse një makinë ndalon në sektorin tënd, përveç rastit kur ajo makinë spostohet mjaftueshëm në një vend të sigurt.
  - Të duhet të ndalosh një pilot në qoftë se sipas gjykimit tënd ai do të arrijë pilotin përpara që po ecën ngadalë.

Gjithashtu të duhet që:

1. Të përdorësh bilbilin në mënyrë që t'i tërheqësh vëmendjen vëzhguesit para teje në rast se duhet të valëvisësh flamurin e kuq.
2. Tërheqja e flamurit sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Të komunikosh me Drejtuesit e Garës në momentin që xhiroja e një garuesi ndalohet për shkak të një aksidenti.
4. Mbaje flamurin e mbledhur dhe të fshehur kur nuk përdoret.
5. Mundohu të mbash spektatorët me veshje të kuqe larg pikës tënde.

Kur një garues shikon një flamur të kuq ai duhet të ndalojë sa më shpejt të mundet në mënyrë të sigurt dhe të presë udhëzime të mëtejshme nga marshallët. Zakonisht ato duhet të lejohen të vazhdojnë ngadalë ose në disa raste t'i kthesh ato në fillim për një xhiro të dytë nga një rrugë tjetër.

### **Marshallët e incidenteve në Hill Climb**

Roli është i njëjtë me atë të Marshallit të Incidenteve në një pistë. Shiko kapitullin e zjarrfikësve dhe menaxhimin e incidenteve më parë në këtë broshurë për më shumë informacion. Do të hasësh kryesisht me makina që kanë përmbajtje metanoli në garat Hill Climb ose sprintet kështu që informohu mbi metanolin në kapitullin e zjarrfikësve. Mundohu të pastrosh mbetjet sa më shpejt, duke shmangur përdorimin e flamurit të kuq.

### **Marshallët e Bokseve në Hill Climb**

Marshallët e Bokseve duhet të:

1. Të kenë dijeni mbi funksionet e Drejtorit të Garës dhe Shefit të Marshallëve.
2. Mbajnë një regjistër të të gjithë konkurrentëve që kanë nënshkruar dhe janë kontrolluar
3. Thërrasin pilotët shumë kohë para sesionit të tyre në mënyrë që ata të jenë gati për të lëvizur të paktën dhjetë minuta para se të kërkohen.



4. Sigurohuni që automjetet të kenë një biletë kontrolli dhe mblidhni një biletë praktike nëse ato janë lëshuar për të siguruar që konkurrentët të japin vetëm numrin e xhirove që u takon.
5. Ndajni makinat në klasa dhe në rend para se të bëhen gati për start. Nëse një konkurrent ka një problem, mbani një shënim, por mos e mbani grumbullin.
6. Këshilloni Marshallin Kryesor të Startit për çdo garues që nuk niset ose tërheqje.
7. Sigurohuni që drejtuesit të jenë në përputhje me çdo rregullore sigurie që është në fuqi. Disa vende këmbëngulin që ata të mbajnë helmata dhe janë të lidhur para se të vazhdojnë në start, veçanërisht nëse ato duhet të përshkruajnë rrugë për të arritur atje.
8. Aty ku është e mundur të drejtoni makina deri në start pa përdorur rrugën, qëndroni në kontakt me startin për të siguruar që ka gjithmonë një numër të arsyeshëm garuesish gati për të bërë xhiro.

Në disa rrugë të Hill Climb është e nevojshme që makinat të kthehen në bokse pasi një grup të ketë përfunduar xhirot e tij, në këtë rast do të ketë një finish në bokse, ku makinat mund të mblidhen pas xhirove të tyre.

Nëse jeni duke kontrolluar një finish në Parc Ferme

1. Sigurohuni që një marshall po pret të drejtojë çdo makinë në një vend parkimi kur të përfundojë.
2. Sigurohuni që zona e energjisë elektrike të jetë e fikur.
3. Mos lejoni që makinat të kthehen drejt vijës së finishit
4. Mbani një vendkalim të pastër për automjetet e urgjencës.
5. Përcaktoni kur një grup do të kthehet në Parc Ferme.
  - Paralajmëroni garuesit dhe sigurohuni që ato automjete që kanë nevojë për ndezës baterie, t'i kenë ato në dispozicion.
  - Normalisht, u takon garuesve që ata të sigurojnë pajimet e nevojshme për të rifilluar.
6. Sigurohuni që garuesit të jenë në përputhje me çdo rregullore sigurie që është në fuqi.
  - Duhet të këmbëngulin që garuesit të mbajnë helmata dhe të kenë të lidhur rripat e sigurimit deri në momentin e ndalimit.

### **Marshallët e vijës së startit**

Konkurrentët sillen në vijën e startit e cila është 10 cm përpara fotocelulës. Marshalli kryesor i startit është përgjegjës për zonën e startit dhe për lidhjen midis matësit të kohës dhe bokseve për të mbajtur një rrjedhë të vazhdueshme të garuesve në rrugë. Linja e Startit do të ketë një zonë mbledhjeje, ku ekipet mund të ndezin automjetet në përparim për të nisur xhiron.



Marshallët përgjegjës për zonën e Grumbullimit të Mjeteve duhet të:

1. Sigurohen që ka një automjet në nisje sa herë që rruga është e lirë.
2. Mbani automjetin tjetër në distancë të sigurt për të shmangur dëmtimet nga gurët që fluturojnë.
3. Sigurohuni që ekipet t'i mbajnë ndezësit e baterive dhe motorët në një pozicion të sigurt, larg nga automjetet e tjera.
4. Është puna e tyre të nisin makinën, jo e juaja, megjithatë, nëse ju ndihmoni në ndezje, kini kujdes se ku e shtyni:
  - Krahët e pasme dhe pjesët plastike mund të dëmtohen nëse shtyni mbi ato.
  - Mos u futni midis rrotave të përparme dhe të pasme të 1-vendësheve kur e ndizni ose shtyni atë.
5. Sigurohuni që konkurrentët të jenë të veshur siç duhet.
6. Këshilloni konkurrentët që ta lenë makinën në pozicionin neutral.
7. Sigurohuni që secili konkurrent e di procedurën e nisjes.
8. Mbani një sy hapur për derdhjen e vajit ose lëngjeve të tjera dhe trajtojeni në përputhje me rrethanat.

Marshallët e startit duhet të:

1. Manovrojnë makinën në pozicionin e nisjes
  - Rrotat e përparme zakonisht japin fuqinë më të mirë, por kini kujdes nga shoferët që përpiqen ta "ndihmojnë" duke ngritur freksionin dhe jini gati të dilni nga rruga nëse freksioni bie aksidentalisht.
  - Rregullojeni automjetin përpara derisa shiriti i kohës të presë rrezet e dritës, pastaj rrokulliseni prapa derisa rrezja e dritës të mos pengohet më.
2. Kontrolloni për copa ose lëngje që rrjedhin kur makina niset dhe trajtojeni në përputhje me rrethanat.
3. Bëhuni gati për të pozicionuar menjëherë makinën tjetër.

Marshallët në Start duhet të qëndrojnë larg makinës sapo të pozicionohet dhe të kenë kujdes të mos shpërqëndrojnë pilotin ose të mos pengojnë dritat e startit. Starti nuk është vend për biseda me pilotët ose kolegët tuaj.

## - Kartingu

Përbën një nga eventet më të ngarkuara dhe me shumë aksion. Marrshallëve u garantohet një ditë e lodhshme por e kënaqshme, ndërkohë që kartet ndalojnë në fund të një sesioni praktike ose gare, tjetri fillon. Detyrat e marrshallëve janë të njëjta me ato të garave dhe të garave të shpejtësisë, por numri i karteve që garojnë rrit mundësitë e incidenteve, ndërkohë që pista e shkurtër dmth, shpejtësi për tu përballur me to, heqja e karteve nga pista ose rivënja e tyre në garë është esenciale.